



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
QENDRA KOMBËTARE E KULTURËS PËR FËMIJË
SEKTORI I FINANCES DHE SHERBIMEVE TE BRENDSHME

Nr. _____ prot

Tiranë, më ____/____/2022

Relacion
Monitorimin 12-mujori 2021

Qendra Kombëtare e Kulturore për Fëmijë ka për qëllimin edukimin dhe argëtimin e fëmijëve, kultivimin e prirjeve, talenteve, formimin e shprehive dhe shkathtësive. QKKF shërben për njohjen, ruajtjen dhe forcimin e traditës kombëtare, edukon atdhedashurinë, si dhe ndihmon për njohjen e vlerave të kulturës botërore.

Në shërbim të edukimit dhe argëtimit, zhvillimit të lirë të mendimit dhe krijimit, talentit dhe aftësisë, QKKF organizon veprimtari shkollore e ndërshkollore, kombëtare dhe ndërkombëtare si: konkurse, olimpiada, festivale, ekspozita, ekskursione, promovime librash, takime me shkrimtarë, kompozitorë, piktorë, aktorë, etj.

Aktivitetet e zhvilluara dhe projektete e realizuara gjete periudhes Janar-Dhjetor2021 jane:

Realizimi i dy premierave teatrale “Peshku i artë” dhe “ Na ishte një herë”

- Ekspozita e Pikturës, me 80 punime në pikturë nga fëmijët e kursit të pikturës
- Ekspozita e Skulpturës me 80 punime të fëmijëve në skulpturë, vizatim dhe qeramikë të cilat u zhvilluan tek Instalacioni REJA.
- Ekspozita e Pikturës “Tirana në telajo” me punime të fëmijëve zhvilluar tek Kalaja e Tiranës
- Shfaqja Kësulëkuqja, me kukulla interpretuar nga fëmijët e kursit të aktrimit dhe Shfaqja Dhelpra dhe Lejleku, ilustruar me kukulla nga fëmijët e kursit të aktrimit. Online
- Dita Botërore e Librit për Fëmijë ku fëmijët e kursit të Skulpturës realizuan disa punime me plasteline dhe vizatime dhe fëmijët e kursit të Pikturës realizuan disa punime nga kopertinat e librave për fëmijë.
- Koncert festiv për festën e 1 Qershorit
- Turi veror “buzeqeshja je ti”
- Aktivitet në kudër të muajit të letërsisë në muajin Tetor me fëmijët e kursit të letërsisë
- Koncert festiv në bashkepunim me Bashkinë Tiranë me rastin e maratonës
- Koncert festiv Ngjyrat e Nentorit
- Ekspozita e pikturës dhe skulpturës për festat e Nentorit
- Dy ekspozita pikturë dhe skulpturë me rastin e festave të fundvitit
- Klipi i vitit të ri

Gjithashtu është realizuar projekti i regjistrimi të 10 shfaqjeve teatrale të cilat për shkak të situatës së pandemisë janë hedhur në facebook në faqen zyrtare të QKKF-së.

Nga fondet buxhetore të planifikuara për periudhën Janar-Dhjetor 2021 në shumën 31,475,000 lekë janë shpenzuar 31,403,011 lekë ose 99.77 % e tyre për shkak të situatës së pandemisë.

Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore është realizuar 99.76 % . Numri i punonjësve të QKKF-së për vitin 2021 ka qënë 30 punonjës sa është edhe organika.

Nga të ardhurat e realizuara jashtë limitit (nga sponsorizimet e Raiffeisen Bank në total 1,290,000 lekë janë shpenzuar të gjitha për llogarinë 604/6 për projektet artistike “Peshku i artë” dhe “ Na ishte një herë”

QKKF realizon të ardhura nga:

- nga dhënia me qira e një ambienti në Teatrin e Kukulave në shumën prej 720,000 lekë në vit, nga të cilat 10% derdhen në buxhetin e shtetit,
- nga dhënia me qira e truallit në lulishten e Kinema Milenium në shumën prej 5,424,000 lekë në vit të cilat 100% derdhen në buxhetin e shtetit,
- nga dhënia me qira e sallës së Teatrit të Kukulave nga të cilat 30% derdhen në buxhetin e shtetit,
- nga shitja e biletave nga të cilat 70% derdhen në buxhetin e shtetit,
- nga tarifa e kurseve artistike nga të cilat 70% derdhen në buxhetin e shtetit,

Të Ardhurat e vitit 2021	Totali Arkëtimeve	Pjesa e institucionit	Derdhur në buxhet
Nga Qiraja	8,043,000	774,000	7,269,000
Nga Biletat	768,100	230,430	537,670
Nga Kurset	308,805	92,642	216,164
Nga Sponsorizimet	1,000,000	1,000,000	-
Totali	10,119,905	2,097,072	8,022,834

Në tabelën e mësipërme shihet qartë se nga të ardhurat totale të realizuara për vitin 2021 (duke përjashtuar sponsorizimet) **8,022,800 lekë janë derdhur në buxhetin e shtetit dhe vetëm 1,097,000 lekë kanë mbetur për shpenzimet operative të institucionit.**

QKKF e ka patur të pamundur realizimin e shumës prej **6,500,000 lekë**, për llogarinë ekonomike 602 kapitulli 5, sipas detajimit të buxhetit për vitin 2021 për arsye se nga të ardhurat që realizohen nga veprimtaria kryesore e aktiviteteve të saj 70 % derdhen në buxhetin e shtetit dhe vetëm 30% e tyre përdoren për mbulimin e shpenzimeve operative.

Të ndodhur në këto rrethana kërkojmë që, ky fakt të merret në konsideratë në shpërndarjen e buxhetit vjetor për QKKF-në.

Përgj. Sek. Financës dhe Shërb. Brendshme

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Adelina Avdulaj

AGIM BAJKO